



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 137/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaqi kryesues, Burim Ademi dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e **Shpresa Miftari** me vendbanim në **Luksemburg**, për shkak të refuzimit të aplikacionit për tu regjistruar në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më 05.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet i bazuar apeli i ushtruar nga **Shpresa Miftari** me vendbanim në **Luksemburg**, **priset pjesërisht** vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me nr. **419-2021** i datës 02.02.2021 për Përfshirjen e Votuesve të Aprovuar në Listën Përfundimtare të Votuesve Jashtë Vendit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021, në pjesën që ka të bëjë me apelin, dhe urdhërohet KQZ-ja, të përfshijë apelin në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Më 03.02.2021 PZAP-i, ka pranuar një apel nga **Shpresa Miftari** kundër vendimit të KQZ-së Nr. **419-2021** i datës 02.02.2021 për Përfshirjen e Votuesve të Aprovuar në Listën Përfundimtare të Votuesve Jashtë Vendit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021, me të cilin është refuzuar aplikacioni i tij që të përfshihet në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës.

Paneli pasi që shqyrtoi apelin konstatoi:

Apeli është i bazuar

Paneli, konstatoi se provat e bashkangjitura nga parashtruesi i apelit janë dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar se i njëjti në kuptim të nenit 5.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme/Lokale (LZP), i plotëson kushtet për tu regjistruar në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës, prandaj në bazë të nenit 118.1 të LZP-së lidhur me nenin 10.7 të Rregullës Zgjedhore nr. 2/2015, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 137/2021 më datën 05.02.2021.

Kryesues i Panelit
Rrustem Thaqi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës, në afat prej njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.